

Republika e Kosovës-Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva – Ministry of Health

Vlerësimi dhe trajtimi i infertilitetit

UDHËRRËFYES KLINIK

Udhërrëfyese Nr.

PRISHTINË 2024

Verzioni :

Komisioni për vlerësimin e metodologjisë së hartimit të udhërrëfyesve dhe protokoleve klinike:

Grupi punues:

Dr. Leandrit Bejtullahu – Kryesues

Dr. Merita Vuniqi Krasniqi – anëtare

Dr. Pranvera Zejnuallahu Raçi – anëtare

Dr. Majlinda Aliu Ibrani – anëtare

Dr. Florina Ushaku Grezda – anëtare

Farmacist - Shpëtim Fazliu - anëtar

Permbajtja:

Përmbledhje-----	5
Për kë është?-----	5
Rekomandime-----	6
1.1 Parimet e kujdesit-----	6
1.2 Këshilla fillestare për njerëzit që shqetësohen për vonesa në mbaresim -----	7
1.3 Hetimi i problemeve të fertilitetit dhe strategjitë e menaxhimit-----	13
1.4 Menaxhimi mjekësor dhe kirurgjikal i problemeve të fertilitetit të faktorit mashkullor-----	19
1.5 Çrregullimet e ovulacionit-----	20
1.6 Kirurgjia e tubave uterine dhe mitrës-----	23
1.7 Menaxhimi mjekësor dhe kirurgjikal i endometriozes-----	24
1.8 Infertiliteti i pa shpjeguar-----	24
1.9 Inseminimi intrauterine -----	25
1.10 Parashikimi i suksesit të FAM-----	26
1.11 Kriteret e qasjes në procedurën e FAM-----	27
1.12 Procedurat e përdorura gjatë trajtimit FAM-----	28
1.13 Injeksioni intracitoplazmatik i spermës-----	33
1.14 Inseminimi me dhurues-----	34
1.15 Dhurimi i oociteve-----	36
1.16 Njerëzit me kancer që dëshirojnë të ruajnë fertilitetin-----	37
1.17 Siguria afatgjatë e teknologjive të ndihmuara riprodhuese për gratë me infertilitet dhe fëmijët e tyre -----	39

2. Termat e përdorura në këtë udhëzues-----	41
3. Menaxhimi pritës-----	41
4. Cikli i plotë-----	41
5. Infertiliteti i lehtë i faktorit mashkullor-----	41
6. FAM-I me cikël natyral-----	41
7. Rekomandime për hulumtim-----	42
8. Menaxhimi para nënshtrimit të procedurave të FAM-----	42
9. Zgjedhja e embrionit për transferimin e një embrioni-----	42
10. Trajtimet mbështetëse të fazës luteale për FAM-----	43
11. Siguria afatgjatë e stimulimit ovarial dhe induksionit të ovulacionit për gratë-----	43
12. Efektet afatgjata të FAM me ose pa injeksion intracitoplazmatik të spermës të fëmijët e ngjizur me FAM-----	43
13. Figurat dhe tabelat për të mbështetur rekomandimet për shanset e konceptimit dhe cilësinë e embrionit-----	45
14. Konteksti-----	50
15. Gjetja e më shumë informacioneve dhe detajet e komitetit-----	52
16. Informacione të përditësuara-----	53
17. Referencat-----	54

1. Hyrje

Vështrim i përgjithshëm:

Ky udhëzues mbulon diagnostikimin dhe trajtimin e problemeve të fertilitetit. Ai synon të reduktojë variacionet në praktikë dhe të përmirësojë mënyrën se si hetohen dhe menaxhohen problemet e fertilitetit.

Për kë dedikohet ky udhërrefyes :

Profesionistët e kujdesit shëndetësor që mirren me problemet e infertilitetit dhe FAM.
Personat me probleme të fertilitetit dhe familjet e tyre.

2. Qëllimi dhe fokusi

Qëllimi i këtij dokumenti është të ofrojë rekomandime për vlerësimin dhe trajtimin e infertilitetit.

3. Të dhënat epidemiologjike

Prevalenca e infertilitetit te femrat është rreth 13% kurse tek meshkujt 10%.

Tek femrat është vërejtur që prevalenca e infertilitetit rritet me moshën. Një studim i bërë në këtë aspekt, tregon që 12% e femrave të moshës 32 vjeçare raportojnë infertilitet, kurse në moshën 38 vjeçare kjo shifër arrin në 21%. Një ndër faktorët vështirsues për trajtimin e infertilitetit është gjendja ekonomike dhe për këtë arsye shumica e vendeve evropiane me politikat e tyre mbështesin trajtimin e infertilitetit. Një nga 4 çiftet në vendet në zhvillim preket nga infertiliteti kurse në nivel botëror sipas organizatës botërore të shëndetësisë (WHO) përqindja e infertilitetit sillet nga 10-15 %. Kjo përqindje ndryshon nga vendi në vend dhe nga rajoni në rajon. Shkaqet e infertilitetit në shumë literatura ka norma të ndryshme (përqindje) po mund të merret parasysh një mesatare me 40% faktorët janë të lidhur për gjininë femërore.

Poashtu 40% faktorët të lidhur për gjininë mashkullore e këtu është shumë me rendësi të ceket se 50 vitet e fundit ka një rritje të madhe të infertilitetit mashkullor ku vërehet një rënie në cilësinë e spermës dhe pretendohet që në disa vende shkon edhe deri 70 % dhe ky fenomen është një shqetësim global për të ardhmen lidhje me infertilitetin mashkullor.

Shkaqet e infertilitetit mashkullor mund të jenë faktorët gjenetik, infeksionet, çrregullimet hormonale, kushtet e jetesës, pozita gjeografike, mirëpo ka arsye të tjera që ndikojnë në këtë rritje të vazhdueshme dhe vëmendje duhet t'i kushtohet disa faktorëve si kequshqyeshmëria, obeziteti, alkooli, duhani, substancat narkotike që konsumohen në vazhdimësi me (trend në rritje) etj.

Megjithatë 20% të të gjitha shkaqeve janë të pashpjegueshme.

Vlerësohet se një në gjashtë njerëz në mbarë botën përjetojnë ndonjë formë të infertilitetit gjatë jetës së tyre ripordhuese. Vetëm në shtetet e BE-së, infertiliteti afekton përafërsisht 25 milion te popullates.

4. Popullata e caktuar:

Personat që kanë probleme me fertilitet.

5. Metodologjia

Grupi punues përmes punëtorive dhe takimeve të rregullta ka analizuar dhe diskutuar sfidat e identifikuar në fushën e infertilitetit si dhe kanë identifikuar mënyrat për të adresuar këto sfida me qëllim të përmbushjes së aktiviteteve dhe arritjes së objektivave të përcaktuara për periudhën kohore të përcaktuar në dokument.

Grupi për adaptimin e udhërrëfyesit është emëruar me vendim të Ministrit të Shëndetësisë, me përbërje prej gjashtë anëtarësh, për të cilët janë hartuar detyrat e punës bazuar në përgjegjësitë e përcaktuara.

Anëtarët e grupit punues:

Dr. Leandrit Bejtullahu – Kryesues

Dr. Merita Vuniqi Krasniqi – anëtare

Dr. Pranvera Zejnuallahu Raçi – anëtare

Dr. Majlinda Aliu Ibrani – anëtare

Dr. Florina Ushaku Grezda – anëtare

Farmacist - Shpëtim Fazliu - anëtar

Të gjithë anëtarët e grupit punues para hartimit të këtij udhërrëfyesi kanë deklaruar se nuk kanë ndonjë konflikt interesi, për çka edhe kanë nënshkruar Deklaratën e konfliktit të interesit. Ky udhërrëfyes është hartuar në përputhje me metodologjinë standarde të procesit të adaptimit të udhërrëfyesve duke u shërbyer me dokumentin AGREE. Janë hulumtuar shumë baza elektronike si Pubmed, Medline, Cochraine, etj. që ndërlidhen me udhërrëfyesit për trajtimin e infertilitetit, të publikuar në mes të viteve. Gjithashtu këto databaza të përmendura më lartë, kanë shërbyer për kërkime të RCT (randomized controlled trials), rishqyrtimeve sistematike dhe meta-analizave. Kërkimi është bërë në gjuhën angleze duke shfrytëzuar fjalët kyçe.

Grupi punues e ka perzgjedhë këtë udhërrëfyes për adaptim pasi që ky udhërrëfyes më së miri i përgjigjet jo vetëm pyetjeve tona shëndetësore, nevojave dhe rrethanave tona pasi që për herë të parë në Kosovë, në institucionet publike po zhvillohet njësi për FAM.

Vendimi është marrë me konsensus nga të gjithë anëtarët e grupit.

Janë analizuar pyetjet shëndetësore, për secilën pyetje janë hulumtuar dëshmitë dhe janë dhënë rekomandimet e përshtatura për rrethanat tona. Vendimet për rekomandime janë arritur me konsensus.

Dedikimi i udhërrëfyesit:

Udhërrëfyesi u dedikohet politik bërësve, menaxherëve të institucioneve shëndetësore dhe profesionistëve shëndetësor, të cilët kanë përgjegjësi për të zhvilluar dhe zbatuar programet e infertilitetit. Gjithashtu udhërrëfyesi ju dedikohet mjekëve specialist Gjinekolog si dhe të gjitha Institucioneve publike dhe private të cilat merren me FAM.

Përderisa fertilizimi i asistuar mjekësor (FAM) ofron një gamë të gjërë të teknikave për t'iu asistuar çifteve infertile apo individëve dhe ekzistojnë dallime në aspekt të qasjes në mes të shteteve të ndryshme.

Termi fertilizim i asistuar mjekësor (FAM) përfshinë në vehte një mori procedurash dhe teknikash të punës me oocite (qelizat gjinore të femrës) dhe spermatozoide (qelizat gjinore të mashkullit) jashtë trupit të njeriut që kanë për qëllim arritjen e fekondimit.

Qëllimi përfundimtar i teknikave të FAM është shtatëzënësia e suksesshme dhe lindja. Themelet e teknikave të FAM datojnë që nga 1973, por në atë kohë të pa sukseshme. Fertilizimi in vitro (IVF) dhe embriotransferi (ET) në FAM modern paraqesin ndër shtyllat kyçe në trajtimin e infertilitetit. Procedurat e IVF realizohen kur oocitet e aspiruara nga ovalet, në medium laboratorik, fertilizohen dhe më tutje embrioni/et vendosen në mitër.

Ekzistojnë dy lloje të procedurave:

Fertilizimi i asistuar mjekësor homolog është frytnimi i asistuar mjekësor me ç`rast përdoren qelizat riprodhuese personale të të dy bashkëshortëve;

Fertilizimi i asistuar mjekësor heterolog është frytnimi i asistuar mjekësor me ç`rast nuk përdoren qelizat riprodhuese personale të njërit bashkëshort por përdoren qelizat e dhuruara.

Për trajtimin homolog (me qeliza vetanake) me të cilin do të fillon punën reparti duhet të përcaktohen kriteret e moshës dhe kriteret klinike, te femra (hormonale, ultrasonografia, histerosalpingografia etj) dhe te mashkulli (spermogrami).

Rastet diskutabile, ankesat etj., do te udhëzohen në KFAM.

Kriteret per perfshirje ne FAM per rastet kur procedurat aplikohen në mes të bashkëshortëve (pa donacion te oociteve):

Mosha 42 vjeçe,kurse mbi kete moshe me leje te KFAM

AMH >0.5 ng/ml

FSH <15 IU/L

Kaviteti i mitrës normale (ose e korigjuar në mënyrë kirurgjikale nëse ka pasur polip/septum)

Procedurat që kryhen dhe pacientët do të regjistrohen në databazën e cila duhet të jetë e integruar në SISH të dhënat do të ruhen në formë digjitale dhe fizike. Qelizat dhe embrionet do të ruhen deri në pesë vjet (sipas dispozitave ligjore) përveç nëse çiftet vendosin për ruajtje në periudhë kohore më të gjatë sipas dispozitave ligjore.

1.1 Parimet e kujdesit

1.1.1 Dhënia e informacionit

1.1.1.1 Çiftet që kanë probleme në ngjizjen duhet të shihen së bashku sepse të dy partnerët preken nga vendimet rreth hulumtimit dhe trajtimit.

1.1.1.2 Çiftet duhet të kenë mundësinë të marrin vendime të informuara në lidhje me kujdesin dhe trajtimin e tyre nëpërmjet aksesit në informacionin e bazuar në prova. Këto zgjedhje duhet të njihen si pjesë integrale e procesit të vendimmarrjes. Informacioni verbal duhet të plotësohet me informacion të shkruar ose media audio-vizuale.

1.1.1.3 Informacioni në lidhje me opsionet e kujdesit dhe trajtimit duhet të ofrohet në një formë që të jetë e çashtme për çiftet që kanë nevoja shtesë, siç janë njerëzit me aftësi të kufizuara fizike, njohëse ose shqisore.

1.1.2 Efektet psikologjike të problemeve të fertilitetit

1.1.2.1 Kur çiftet kanë probleme me fertilitetin, të dy partnerët duhet të informohen se stresi në partnerin mashkull ose femër mund të ndikojë në marrëdhënie në çift dhe ka të ngjarë të zvogëlojë epshin dhe shpeshtësinë e marrëdhënieve, të cilat mund të kontribuojnë në problemet e fertilitetit.

1.1.2.2 Çiftet që përjetojnë probleme të fertilitetit duhet të informohen se mund ta kenë të dobishme të kontaktojnë një grup mbështetës të fertilitetit.

1.1.2.3 Personave që përjetojnë probleme të fertilitetit duhet t'u ofrohet këshillim sepse vetë problemet e fertilitetit dhe hetimi dhe trajtimi i problemeve të fertilitetit mund të shkaktojnë stres psikologjik.

1.1.2.4 Këshillimi duhet të ofrohet para, gjatë dhe pas hetimit dhe trajtimit, pavarësisht nga rezultati i këtyre procedurave.

1.1.2.5 Këshillimi duhet të ofrohet nga dikush që nuk është i përfshirë drejtpërdrejt në menaxhimin e problemeve të fertilitetit të individit dhe/ose çiftit.

1.1.3 Kujdesi gjeneralist dhe specialist

1.1.3.1 Njerëzit që përjetojnë probleme të fertilitetit duhet të trajtohen nga një ekip specialist, sepse kjo ka të ngjarë të përmirësojë efektivitetin dhe efikasitetin e trajtimit dhe dihet se përmirëson kënaqësinë e njerëzve me trajtimin.

1.2 Këshilla fillestare për çiftet e shqetësuar për vonesat në konceptim

1.2.1 Mundësia e konceptimit

1.2.1.1 Personat që shqetësohen për fertilitetin e tyre duhet të informohen se mbi 80% e çifteve të moshës reproduktive mund të arrijnë shtatzënesinë brenda 1 viti nëse nuk përdorin kontracepsion dhe kryejnë marrëdhënie të rregullta seksuale.

Nga ata që nuk mbeten shtatzënë në vitin e parë, rreth gjysma do ta bëjnë këtë në vitin e dytë (shkalla kumulative e shtatzënisë mbi 90%).

1.2.1.2 Informoni çiftet që përdorin fekondimin artificial për të mbetur shtatzënë dhe që janë të shqetësuar për fertilitetin e tyre se:

- Mbi 50% e grave të moshës nën 40 vjeç mund të mbeten shtatzënë brenda 6 cikleve të inseminimit intrauterin (IUI)

1.2.1.3 Informoni çiftet që përdorin inseminim artificial për të mbetur shtatzënë dhe që janë të shqetësuar për fertilitetin e tyre se përdorimi i spermës së freskët shoqërohet me norma më të larta ngjizje sesa sperma e ngrirë-shkrirë. Megjithatë, inseminimi intrauterin, edhe duke përdorur spermë të ngrirë-shkrirë, shoqërohet me norma më të larta konceptimi sesa inseminimi intracervikal.

1.2.1.4 Informoni çiftet që janë të shqetësuar për fertilitetin e tyre, se fertiliteti femëror (dhe në një masë më të vogël fertiliteti mashkullor) bie me moshën.

1.2.1.5 Diskutoni shanset e ngjizjes me çiftet të shqetësuar për fertilitetin e tyre të cilët janë:

- kryerja e marrëdhënieve seksuale ose
- duke përdorur inseminim artificial

1.2.2 Frekuenca dhe koha e marrëdhënieve seksuale ose inseminimit artificial

1.2.2.1 Çiftet që shqetësohen për fertilitetin e tyre duhet të informohen se marrëdhëniet seksuale vaginale rreth kohës se ovulacionit optimizojnë mundësinë e shtatzënisë.

1.2.2.2 Çiftet që përdorin fekondim artificial për të mbetur shtatzënë duhet të kenë kohën e inseminimit të caktuar rreth ovulacionit të tyre.

1.2.3 Alkooli

1.2.3.1 Gratë që përpiqen të mbeten shtatzënë duhet të informohen se pirja e jo më shumë se 1 ose 2 njësi alkooli një ose dy herë në javë dhe shmangia e episodeve të dehjes zvogëlon rrezikun e dëmtimit të fetusit në zhvillim.

1.2.3.2 Burrat duhet të informohen se konsumimi i alkoolit brenda rekomandimeve të Departamentit të Shëndetësisë dhe Kujdesit Social prej 3 deri në 4 njësi në ditë për meshkujt nuk ka gjasa të ndikojë në cilësinë e spermës së tyre.

1.2.3.3 Burrat duhet të informohen se marrja e tepërt e alkoolit është e dëmshme për cilësinë e spermës.

1.2.4 Pirja e duhanit

1.2.4.1 Gratë që pinë duhan duhet të informohen se kjo ka të ngjarë të zvogëlojë fertilitetin e tyre.

1.2.4.2 Grave që pinë duhan duhet t'u ofrohet referimi në një program për lënien e duhanit për të mbështetur përpjekjet e tyre për të ndaluar pirjen e duhanit.

1.2.4.3 Gratë duhet të informohen se duhanpirja pasive ka të ngjarë të ndikojë në mundësinë e tyre për të mbetur shtatzënë.

1.2.4.4 Burrat që pinë duhan duhet të informohen se ekziston një lidhje midis pirjes së duhanit dhe cilësisë së reduktuar të spermës (megjithëse ndikimi i kësaj në fertilitetin mashkullor është i pasigurt), dhe se ndalimi i pirjes së duhanit do të përmirësojë shëndetin e tyre të përgjithshëm.

1.2.5 Pijet me kafeinë

1.2.5.1 Çiftet të cilët janë të shqetësuar për fertilitetin e tyre duhet të informohen se nuk ka dëshmi të qëndrueshme të një lidhjeje midis konsumit të pijeve me kafeinë (çaj, kafe dhe kola) dhe problemeve të fertilitetit. Shih gjithashtu rekomandimin 1.10.5.3 në lidhje me marrjen e kafeinës dhe trajtimin e fekondimit in vitro (IVF).

1.2.6 Obeziteti

1.2.6.1 Gratë që kanë një indeks të masës trupore (BMI) prej 30 ose më shumë duhet të informohen se ka të ngjarë të marrin më shumë kohë për të mbetur shtatzënë.

1.2.6.2 Gratë që kanë një BMI prej 30 ose më shumë dhe që nuk janë në ovulacion duhet të informohen se humbja e peshës ka të ngjarë të rrisë shanset e tyre për ngjizje.

1.2.6.3 Gratë duhet të informohen se pjesëmarrja në një program grupor që përfshin ushtrime dhe këshilla dietike çon në më shumë shtatzëni sesa vetëm këshilla për humbje peshe.

1.2.6.4 Burrat që kanë një BMI prej 30 ose më shumë duhet të informohen se ata kanë gjasa të kenë fertilitet të reduktuar.

1.2.7 Pesha e ulët trupore

1.2.7.1 Gratë që kanë një BMI më të vogël se 19 dhe që kanë menstruacione të çrregullta ose nuk kanë menstruacione duhet të këshillohen se rritja e peshës trupore ka të ngjarë të përmirësojë shanset e tyre për ngjizje.

1.2.8 Të brendshme të ngushta

1.2.8.1 Burrat duhet të informohen se ekziston një lidhje midis temperaturës së ngritur të skrotumit dhe cilësisë së reduktuar të spermës, por se është e pasigurt nëse veshja e të brendshmeve të gjera përmirëson fertilitetin.

1.2.9 Profesioni

1.2.9.1 Disa profesione përfshijnë ekspozimin ndaj rreziqeve që mund të zvogëlojnë fertilitetin mashkullor ose femëror dhe për këtë arsye duhet të bëhet një pyetje specifike në lidhje me profesionin për njerëzit që janë të shqetësuar për fertilitetin e tyre dhe duhet të ofrohet këshilla e duhur.

1.2.10 Përdorimi i barnave pa recetë dhe drogave rekreative

1.2.10.1 Një numër i barnave të cilat merren pa recetë dhe drogave rekreative ndërhyjnë në fertilitetin femëror dhe atë mashkullor, prandaj duhet të ju kushtohet vëmendje dhe hulumtim i veçantë nga profesionistët shëndetësorë dhe të ofrohen këshilla specifike dhe të përshtatshme rreth përdorimit dhe efektit të tyre në fertilitet.

1.1.2 Terapia plotësuese

1.1.2.1 Çiftet të cilët janë të shqetësuar për problemet e fertilitetit duhet të informohen se efektiviteti i terapisë plotësuese për problemet e fertilitetit nuk është hulumtuar siç duhet, prandaj hulumtime të më mëtejme kërkimore është e nevojshme të kryhen para se të tilla terapi mund të rekomandohen.

1.1.3 Shtesa me acid folik

1.1.3.1 Gratë që synojnë të mbeten shtatzënë duhet të informohen se plotësimi dietik me acid folik para konceptimit dhe deri në javën e 12 të shtatzënisë zvogëlon rrezikun e lindjes së një fëmije me defekte të tubit neural. Doza e rekomanduar është 400 mcg në ditë.

Për gratë që kanë pasur më parë një foshnjë me një defekt të tubit neural, që marrin mjekim anti-epileptik ose që kanë diabet, rekomandohet një dozë më e lartë prej 800 mcg në ditë.

1.1.4 Përcaktimi i infertilitetit

1.1.4.1 Çifteve që shqetësohen për vonesat në konceptim duhet t'u ofrohet një vlerësim fillestar. Duhet të bëhet një hulumtim specifik në lidhje me stilin e jetës dhe jetën seksuale për të identifikuar personat që kanë më pak gjasa të mbeten shtatzënë.

1.1.4.2 Ofroni një konsultë fillestare për të diskutuar opsionet për tentimin e ngjizjes çifteve që nuk janë në gjendje të kryejnë marrëdhënie seksuale me penetrim.

1.1.4.3 Mjedisi në të cilin zhvillohet hulumtimi i problemeve të fertilitetit duhet t'u mundësojë çifteve të diskutojnë çështje të ndjeshme si abuzimi seksual.

1.1.4.4 Profesionistët e kujdesit shëndetësor duhet ta përcaktojnë infertilitetin në praktikë si periudhën kohore kur çiftet janë përpjekur të kenë një shtatzani pa sukses, dhe pas së cilës duhet të hulumtohet dhe të zbatohet trajtimi i mundshëm.

1.1.4.5 Një gruajë në moshë riprodhuese e cila nuk ka mbetur shtatzënë pas 1 viti marrëdhënie seksuale të pambrojtur, në mungesë të ndonjë shkakut të njohur të infertilitetit, duhet t'i ofrohet një vlerësim dhe hulumtim i mëtejshëm klinik së bashku me partnerin e saj.

1.1.4.6 Një gruajë në moshë riprodhuese e cila i nënshtrohet inseminimit artificial për të mbetur shtatzënë duhet t'i ofrohet vlerësim dhe hulumtim klinik i mëtejshëm nëse ajo nuk ka mbetur shtatzënë pas 6 cikle trajtimi, në mungesë të ndonjë shkakut të njohur të infertilitetit. Në rastet kur është përdorur sperma e partnerit, referimi për vlerësimin dhe hulumtimin klinik duhet të përfshijë edhe partnerin e saj.

1.1.4.7 Ofroni një referim për konsultim specialistik, për të diskutuar opsionet për tentimin e konceptimit, vlerësimin e mëtejshëm dhe trajtimin e duhur ku:

- gruajë është 36 vjeç e më shumë.
- ekziston një shkak klinik i njohur i infertilitetit ose një histori e faktorëve predispozues për infertilitet.

1.1.4.8 Aty ku planifikohet trajtimi që mund të rezultojë në infertilitet (si trajtimi për kancerin), duhet të ofrohet referimi i hershëm te specialisti i infertilitetit.

1.1.4.9 Çiftet të cilët janë të shqetësuar për fertilitetin e tyre dhe që dihet se kanë infeksione kronike virale, si hepatiti B, hepatiti C ose HIV, duhet t'u referohen qendrave që kanë ekspertizën dhe pajisjet e duhura për të ofruar hulumtim dhe trajtim të sigurt për reduktimin e rrezikut.

1.3 Hetimi i problemeve të fertilitetit dhe strategjitë e menaxhimit

1.3.1 Analiza e spermës

1.3.1.1 Rezultatet e analizës së spermës së kryer si pjesë e një vlerësimi fillestar duhet të krahasohen me vlerat e mëposhtme të referencës së Organizatës Botërore të Shëndetësisë (2021):

- Vëllimi i spermës: 1.4 (1.3-1.5) ml
- pH: 7.2 ose më shumë
- Përqendrimi i spermës: 15 milionë spermatozoide për ml ose më shumë
- Numri total i spermatozoideve: 39 (35–40)milionë spermatozoide për ejakulat ose më shumë
- lëvizshmëri totale (përqindja e lëvizshmërisë progresive dhe lëvizshmërisë jo progresive): 42 % (40–43) ose më shumë lëvizëse ose 30 % (29–31)ose më shumë me lëvizshmëri progresive.
- vitalitet: 54 % (50–56) ose më shumë spermatozoide të gjalla
- morfologjia e spermës (përqindja e formave normale): 4 % (3.9–4)ose më shumë.

1.3.1.2 Skreningu për antitropa antispermaticë nuk duhet të ofrohet si procedure standarde.

1.3.1.3 Nëse rezultati i analizës së parë të spermës është jonormal, duhet të ofrohet një test konfirmues i përsëritur.

1.3.1.4 Testet konfirmuese të përsëritura duhet të kryhen në mënyrë ideale 3 muaj pas analizës fillestare për të lejuar kohë për të përfunduar ciklin e formimit të spermatozoideve. Sidoqoftë, nëse zbulohet një mungesë e madhe e spermatozoideve (azoospermia ose oligozoospermia e rëndë), testi i përsëritur duhet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur.

1.3.2 Testimi post-koital i mukusit cervical:

1.3.2.1 Përdorimi rutinë i testimit post-koital të mukusit të qafës së mitrës në hetimin e problemeve të fertilitetit nuk rekomandohet sepse nuk ka vlerë parashikuese në shkallën e shtatzënisë.

1.3.3 Testimi i rezervës ovariale

1.3.3.1 Përdorni moshën e një gruaje si një parashikues fillestar të mundësisë së saj të përgjithshme për sukses nëpërmjet konceptimit natyral ose me FAM .

1.3.3.2 Përdorni një nga masat e mëposhtme për të parashikuar përgjigjen e mundshme ovariale ndaj stimulimit të gonadotropinës në FAM:

- Numri total i folikulave antral më pak se ose i barabartë me 4 për një reagim të ulët (low response) folikulat më pak se ose të barabarta me 5 mm të matura me ultrazërin transvaginal në ditën e tretë të ciklit: reagim i ulët ishte më pak se 4 oocite) dhe më e madhe se 16 për një reagim të lartë high response (folikulat prej 2 deri në 10 mm të matura me ultrazërin transvaginal në ditën e 3 të ciklit: reagim i lartë high response ishte më shumë se ose e barabartë me 15 oocite ose më shumë se ose e barabartë me 20 oocite)
- Hormoni anti-Müllerian më pak se ose i barabartë me 5,4 pmol/l për një vlerë të ulët (analizimi Beckman-Coulter: përgjigja e dobët e përcaktuar si më pak se 4 oocite ose anulim) dhe më e madhe se ose e barabartë me 25,0 pmol/l për një vlerë të lartë. (Analizat Beckman-Coulter ose DSL: Përcaktimi i vlerë së lartë si më shumë se ose e barabartë me 15 oocite për më shumë se 21 ovocite)
- Hormoni folikulo-stimulues më i madh se 8,9 IU/l për një vlerë të ulët dhe më pak se 4 IU/l për një vlerë të lartë (protokolli i gjatë i rregullimit të ulët: vlerë e ulët e përcaktuar si më pak se 4 oocite ose asnjë; vlerë e lartë e përcaktuar si më shumë se 20 ovocite).

1.3.4 Rregullsia e cikleve menstruale

1.3.4.1 Gratë që shqetësohen për fertilitetin e tyre duhet të pyeten për shpeshësinë dhe rregullsinë e cikleve të tyre menstruale. Gratë me cikle të rregullta mujore duhet të informohen se duhet të përcillet ovulacioni.

1.3.4.2 Grave që po i nënshtrohen hulumtimeve të analizave për infertilitet duhet t'u ofrohet një test gjaku për të matur progesteronin në serum në fazën e mesme luteale

të ciklit të tyre (dita e 21 e një cikli 28-ditor) për të konfirmuar ovulimin edhe nëse kanë cikle menstruale të rregullta.

1.3.4.3 Grave me cikle menstruale të parregullta të zgjatura duhet t'u ofrohet një test gjaku për të matur progesteronin në serum. Në varësi të kohës së periudhave menstruale, ky test mund të kryhet më vonë gjatë ciklit (për shembull, dita 28 e një cikli 35-ditor) dhe të përsëritet çdo javë më pas derisa të fillojë cikli i ardhshëm menstrual.

1.3.4.4 Përdorimi i grafikëve të temperaturës bazale të trupit për të konfirmuar ovulimin nuk e parashikon me besueshmëri ovulimin dhe nuk rekomandohet.

1.3.4.5 Grave me cikle menstruale të parregullta duhet t'u ofrohet një test gjaku për të matur gonadotropinat në serum (hormoni folikulo stimules dhe hormoni luteinizues).

1.3.5 Matja e prolaktinës

1.3.5.1 Testi i prolaktines duhet te ofrohet ne menyre rutinore per vleresimin e infertilitetit.

1.3.6 Testet e funksionit të tiroides

1.3.6. Testet e funksionit të tiroides duhet te ofrohen ne menyre rutinore per vleresimin e infertilitetit.

1.3.7 Biopsia endometriale

1.3.7.1 Grave nuk duhet t'u behet ne menyre rutinore biopsia endometriale për të vlerësuar fazën luteale si pjesë e hetimit të problemeve të fertilitetit, përveq në raste kur vlerësohet që kjo është e arsyeshme .

1.3.8 Hetimi i anomalive të dyshuara tubare dhe uterine

1.3.8.1 Grave që nuk dihet se kanë sëmundje shoqëruese (si sëmundjet inflamatorë të pelvikut , shtatzënia e mëparshme ektopike ose endometrioza) duhet t'u ofrohet histerosalpingografia (HSG) për të kontrolluar kalueshmërinë e tubave, sepse ky është një test i besueshëm për të përjashtuar mbylljen e tubave, dhe është më pak invazive dhe përdor më efikas sesa laparoscopia.

1.3.8.2 Aty ku disponohet ekspertiza e duhur, duhet të merret në konsideratë ekzaminimi për kalueshmërinë e tubave duke përdorur histerosalpingo-kontrast-ultrasonografi, sepse është një alternativë efektive ndaj HSG për gratë që nuk dihet se kanë sëmundje shoqëruese.

1.3.8.3 Grave që mendohet se kanë sëmundje shoqëruese duhet t'u ofrohet laparoscopi në mënyrë që të mund të vlerësohen në të njëjtën kohë patologjitë tubare dhe të tjera të pelvikut.

1.3.8.4 Grave nuk duhet t'u ofrohet histeroscopia më vete si pjesë e hulumtimit fillestar, përveç rasteve kur indikohet klinikisht.

1.3.9 Testimi për semundjet virale

1.3.9.1 Personave që i nënshtrohen trajtimit FAM duhet t'u ofrohet testimi për HIV, hepatitin B dhe hepatitin C (për inseminimin e donatorëve, shih rekomandimin 1.14.3.1).

1.3.9.2 Çifteve që zbulohen se janë testuar pozitivë për HIV, hepatit B ose hepatit C duhet t'u ofrohet këshilla dhe këshillim specialistik dhe menaxhimi i duhur klinik.

1.3.10 Transmetimi viral

1.3.10.1 Për çiftet ku burri është HIV pozitiv, çdo vendim për menaxhimin e fertilitetit duhet të jetë rezultat i diskutimeve midis çiftit, një specialisti të fertilitetit dhe një specialisti për HIV (infektologut).

1.3.10.2 Këshilloni çiftet ku burri është HIV pozitiv se rreziku i transmetimit të HIV te partnerja femër është i papërfillshëm nëpërmjet marrëdhënieve seksuale të pambrojtura kur plotësohen të gjitha kriteret e mëposhtme:

- mashkulli është në përputhje me terapinë antiretrovirale shumë aktive (HAART)
- burri ka pasur një nivele plazmatike virale më pak se 50 njesi /ml për më shumë se 6 muaj
- nuk ka infeksione të tjera të pranishme
- Marrëdhënia e pambrojtur është e kufizuar në kohën e ovulacionit.

1.3.10.3 Këshilloni çiftet që nëse plotësohen të gjitha kriteret në rekomandimin e lartecukur 1.3.1.2 "larja e spermës" mund të mos reduktojnë më tej rrezikun e infeksionit dhe mund të zvogëlojnë gjasat për shtatzëni.

1.3.10.4 Për çiftet ku burri është HIV pozitiv dhe ose ai nuk është në përputhje me HAART ose ngarkesa virale e tij plazmatike është 50 njesi /ml ose më shumë, ofroni "larje të spermës".

1.3.10.5 Informoni çiftet se "larja e spermës" redukton, por nuk eliminon rrezikun e transmetimit të HIV-it.

1.3.10.6 Nëse çiftet që plotësojnë të gjitha kriteret në rekomandimin 1.3.10.2 ende perceptojnë një rrezik të papranueshëm të transmetimit të HIV pas diskutimit me specialistin e tyre HIV, merrni parasysh "larjen e spermës" .

1.3.10.7 Informoni çiftet se nuk ka prova të mjaftueshme për të rekomanduar që gratë HIV-negative të përdorin profilaksinë e para-ekspozimit, kur plotësohen të gjitha kriteret në rekomandimin 1.3.10.2.

1.3.10.8 Për partnerët e personave me hepatit B, ofroni vaksinim përpara se të filloni trajtimin e fertilitetit.

1.3.10.9 Mos ofroni “larje të spermës” si pjesë e trajtimit të fertilitetit për burrat me hepatit B.

1.3.10.10 Për çiftet ku burri ka hepatit C, çdo vendim për menaxhimin e fertilitetit duhet të jetë rezultat i diskutimeve midis çiftit, një specialisti të fertilitetit dhe një specialisti të hepatitit (infektologut).

1.3.10.11 Këshilloni çiftet që duan të mbeten shtatzënë dhe ku burri ka hepatit C që rreziku i transmetimit përmes marrëdhënieve seksuale të pambrojtura mendohet të jetë i ulët.

1.3.10.12 Burrat me hepatit C duhet të diskutojnë opsionet e trajtimit për të çrrënjosur hepatitin C me specialistin e tyre të duhur përpara se të merret në konsideratë konceptimi.

1.3.11 Ndjeshmëria ndaj rubeolës

1.3.11.1 Grave që shqetësohen për fertilitetin e tyre duhet t’u ofrohet testimi për statusin e rubeolës në mënyrë që atyre që janë të ndjeshme ndaj rubeolës t’u ofrohet vaksinimi. Gratë që janë të ndjeshme ndaj rubeolës duhet t’u ofrohet vaksinimi dhe të këshillohen të mos mbeten shtatzënë për të paktën 1 muaj pas vaksinimit.

1.3.12 Ekzaminimi i kancerit të qafës së mitrës

1.3.12.1 Për të shmangur vonesën në trajtimin e fertilitetit, duhet të bëhet një hulumtim specifik në lidhje me kohën dhe rezultatin e PAP testit për skringun e kancerit së qafës së mitrës.

1.3.13 Ekzaminimi për Chlamydia trachomatis

1.3.13.1 Përpara se t’i nënshtrohen procedurave të FAM –it , grave duhet t’u ofrohet testimi për Chlamydia trachomatis duke përdorur një teknikë të përshtatshme për detektimin e saj .

1.3.13.2 Nëse rezultati i një testi për Chlamydia trachomatis është pozitiv, gratë dhe partnerët e tyre seksualë duhet të referohen për menaxhimin e duhur me trajtim dhe gjurmim kontakti.

1.3.13.3 Antibiotikët profilaktikë duhet të merren parasysh përpara realizimit të procedurave intervenuese brenda në mitër nëse nuk është kryer ekzaminimi.

1.4 Menaxhimi mjekësor dhe kirurgjik i problemeve të faktorit mashkullor të fertilitetit

1.4.1 Menaxhimi mjekësor (infertiliteti i faktorit mashkullor)

1.4.1.1 Meshkujt me hipogonadizëm hipogonadotrop duhet t’iu ofrohen barna gonadotropinike sepse këto janë efektive në përmirësimin e fertilitetit.

1.4.1.2 Meshkujt me anomali idiopatike të spermës nuk duhet t’iu ofrohen anti-estrogenë, gonadotropine, androgenë, bromokriptinë ose barna për përmirësimin ritjen e kininës sepse nuk është treguar se janë efektive.

1.4.1.3 Mashkujt duhet të informohen se rendesia e antitropave antispermatozoid është e paqartë dhe efektshmëria e kortikosteroideve sistematike është e pasigurte.

1.4.1.4 Mashkujt me prani të leukociteve në spermen e tyre nuk duhet t'iu ofrohen trajtim me antibiotikë nëse nuk ka një infeksion të identifikuar sepse nuk ka prova që kjo përmirëson shkallën e shtatzënisë.

1.4.2 Menaxhimi kirurgjik (infertiliteti i faktorit mashkullor)

1.4.2.1 Aty ku disponohet ekspertiza e duhur, mashkujve me azoospermi obstruktive duhet t'iu ofrohet korigjimi kirurgjik i bllokimit epididimal nga ana e urologut sepse ka të ngjarë të rivendose kalueshmërinë e kanalit dhe të përmirësojë fertilitetin. Korigjimi kirurgjik duhet të konsiderohet si një alternativë për rikuperimin kirurgjik të spermës dhe FAM.

1.4.2.2 Meshkujve nuk duhet t'iu ofrohet nderhyrje kirurgjikale për varikocelë si një procedurë e rregullt e trajtimit të fertilitetit sepse nuk është vertetuar që përmirëson shkallën e shtatzënisë.

1.4.3 Menaxhimi i dështimit të ejakulimit

1.4.3.1 Trajtimi i dështimit të ejakulimit mund të rivendosë fertilitetin pa nevojë për metoda invazive të marrjes së spermës ose përdorimin e procedurave të riprodhimit të asistuar. Megjithatë, nevojitet një vlerësim i metejshëm më i thellë i opsioneve të ndryshme të trajtimit.

1.5.Ç'rregullimet e ovulacionit

Klasifikimi i çrregullimeve të ovulacionit

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) klasifikon çrregullimet e ovulacionit në 3 grupe:

- Grupi 1: dështimi hipotalamik hipofiziar (amenorrea hipotalamike ose hipogonadizëm hipogonadotrop)
- Grupi 2: disfunksioni hipotalamik-hipofiziar-vezorial (kryesisht sindroma polikistike e vezoreve)
- Grupi 3: dështimi ovarial.

1.5.1 Çrregullimet e ovulacionit të Grupit 1 të OBSH-së

1.5.1.1 Rekomandoni grave me infertilitet anovulator të Grupit 1 të OBSH-së që ato mund të

përmirësojnë mundësinë e tyre për ovulim të rregullt, konceptim dhe një shtatzëni të pakomplikuuar duke:

1.5.1.1.1 duke rritur peshën e tyre trupore nëse kanë BMI më të vogël se 19 dhe/ose

1.5.1.1.2 duke moderuar nivelet e tyre të stervitjes nëse i janë nënshtruar sforcimeve të niveleve të larta.

1.5.1.2 Ofroni grupe me çrregullime të ovulacionit të Grupit 1 të OBSH-së, administrimin pulsativ të hormonit çlirues të gonadotropinës ose gonadotrofinave me aktivitet të hormonit luteinizues për të nxitur ovulimin.

1.5.2 Çrregullimet e ovulacionit të Grupit 2 të OBSH-së

Gratë me çrregullime të ovulacionit të Grupit 2 të OBSH-së që marrin trajtim të linjës së parë për stimulimin e vezoreve

1.5.2.1 Këshilloni gratë me infertilitet anovulator të Grupit 2 të OBSH-së që kanë një BMI prej 30 ose më shumë për të humbur peshë (shih rekomandimin 1.2.6.3). Informoni ato se BMI e rregullt e vetme mund të rivendosë ovulacionin, të përmirësojë reagimin e tyre ndaj agjentëve të induksionit të ovulacionit dhe të ketë një ndikim pozitiv në shtatzëni.

1.5.2.2 Ofroni grupe me infertilitet anovulator të Grupit 2 të OBSH-së 1 nga trajtimet e mëposhtme, duke marrë parasysh efektet e mundshme negative, lehtësinë dhe mënyrën e përdorimit, BMI-në e gruas dhe monitorimin e nevojshëm:

1.5.2.2.1 klomifen citrat ose

1.5.2.2.2 metforminë ose

1.5.2.2.3 një kombinim i mesiperm.

1.5.2.3 Për gratë që marrin klomifen citrate, ofroni monitorim me ultratingull të paktën gjatë ciklit të parë të trajtimit për t'u siguruar që ato marrin dozen që minimizon rrezikun e shtatzënisë së shumëfishtë.

1.5.2.4 Për gratë që marrin klomifen citrate, te mos e vazhdojnë trajtimin për më shumë se 6 muaj.

1.5.2.5 Grave të cilave u është përshkruar metformina duhet të informohen për efektet anësore të lidhura me përdorimin e saj (të tilla si nauze, të vjella dhe shqetësime të tjera gastrointestinale).

Gratë me çrregullime të ovulacionit të Grupit 2 të OBSH-së, të cilat dihet se janë rezistente ndaj klomifen citratit

1.5.2.6 Për gratë me çrregullime të ovulacionit të Grupit 2 të OBSH-së, të cilat dihet se janë rezistente ndaj klomifen citratit, merrni parasysh 1 nga trajtimet e mëposhtme të linjës së dytë, në varësi të rrethanave klinike dhe preferencës së gruas:

1.5.2.6.1 drilingu i vezoreve me procedure laparoskopike

1.5.2.6.2 trajtim i kombinuar me klomifen citrat dhe metforminë nëse nuk ofrohet tashmë si trajtim i linjës së parë ose

1.5.2.6.3 gonadotropinat.

1.5.2.7 Grave me sindromën e vezores policistike që trajtohen me gonadotropina nuk duhet t'u ofrohet trajtim me agonist të hormoneve çliruese gonadotropine në të njëjtën kohë, sepse nuk përmirëson shkallën e shtatzënisë dhe shoqërohet me një rrezik të shtuar të hiperstimulimit vezorial.

1.5.2.8 Përdorimi i trajtimit ndihmës të hormonit të rritjes me agonist të hormonit çlirues të gonadotropinës dhe/ose gonadotropinë njerëzore të menopauzës(HMG) gjatë induksionit të ovulacionit tek gratë me sindromën e vezores policistike që nuk i përgjigjen klomifen citratit nuk rekomandohet sepse nuk përmirëson shkallën e shtatzënisë.

1.5.2.9 Efektiviteti i hormonit pulsativ që çliron gonadotropinën tek gratë me sindromën e vezores policistike rezistente ndaj klomifen citratit është i pasigurt dhe për këtë arsye nuk rekomandohet jashtë një konteksti kërkimor.

1.5.3 Amenorrea hiperprolaktinemike – agonistët e dopaminës

1.5.3.1 Grave me çrregullime të ovulacionit për shkak të hiperprolaktinemisë duhet t'u ofrohet trajtim me agonistë dopamine si bromokriptina. Duhet t'i kushtohet vëmendje sigurisë për përdorim gjatë shtatzënisë dhe minimizimit të kostos gjatë përshkrimit.

1.5.4 Monitorimi i induksionit të ovulacionit gjatë terapisë me gonadotropinë

1.5.4.1 Grave të cilave u ofrohet induksioni i ovulacionit me gonadotropina duhet të informohen për rrezikun e shtatzënisë së shumëfishtë dhe hiperstimulimit ovarial përpara fillimit të trajtimit.

1.5.4.2 Monitorimi me ultraze i vezoreve për të matur madhësinë e folikulave dhe numrin e tyre duhet të jetë pjesë integrale e terapisë me gonadotropine për të reduktuar rrezikun e shtatzënisë së shumëfishtë dhe hiperstimulimin vezorial.

1.6 Kirurgjia e tubave dhe e mitrës

1.6.1 Mikrokirurgjia tubare dhe kirurgjia laparoskopike e tubave

1.6.1.1 Për gratë me patologji të moderuar tubare, intervenimi kirurgjik në tuba mund të jetë më efektiv, se pa trajtim. Në qendrat ku ekziston ekspertiza e duhur, mund të konsiderohet si një opsion trajtimi.

1.6.2 Kateterizimi ose kanulimi tubar

1.6.2.1 Për gratë me obstrukcion tubar proksimal, salpingografia selektive plus

kateterizimi tubar, ose kanulimi histeroskopik tubar, mund të jenë opsione trajtimi sepse këto trajtime përmirësojnë mundësinë e shtatzënise.

1.6.3 Intervenimet operatorë kirurgjike për hidrosalpinget përpara trajtimit me FAM

1.6.3.1 Grave me hidrosalping duhet t'u ofrohet salpingektomia, mundësisht me laparoskop, përpara trajtimit me FAM sepse kjo përmirëson (rrit) mundësinë e një shtatezenie të sukseshme.

1.6.4 Intervenimet operatorë kirurgjike në miter

1.6.4.1 Grave me amenorre që zbulohet se kanë ngjitje intrauterine duhet t'u ofrohet largimi histeroskopik i sinehijeve sepse kjo ka të ngjarë të rivendosë menstruacionet dhe të përmirësojë mundësinë (gjasat) për shtatzëni.

1.6.4.2 Menaxhimi mjekësor dhe kirurgjik i endometrioze

Ky seksion është hequr pasi është zëvendësuar nga publikimi i udhëzuesit NICE për endometriozen.

1.7 Infertilitet i pashpjegueshëm

1.7.1 Stimulimi ovarial për infertilitet të pashpjegueshëm

1.7.1.1 Mos ofroni agjentë stimules oral të vezoreve (të tilla si klomifen citrati, anastrozol ose letrozol) për gratë me infertilitet të pashpjegueshëm.

1.7.1.2 Informoni gratë me infertilitet të pashpjegueshëm se klomifen citrati si një trajtim i pavarur nuk rrit shanset për shtatzëni ose lindje të sukseshme të gjalle.

1.7.1.3 Këshilloni gratë me infertilitet të pashpjegueshëm që kanë marrëdhënie seksuale të pambrojtura të rregullta që të përpiqen të mbeten shtatzënë për një periudhë kohore prej 2 vitesh (kjo mund të përfshijë deri në 1 vit përpara hetimeve të tyre të fertilitetit) përpara se të merret në konsideratë FAM.

1.7.1.4 Ofroni trajtim FAM për grate

me infertilitet të pashpjegueshëm që nuk kanë mbetur shtatzënë pas periudhes kohore prej 2 vitesh (kjo mund të përfshijë deri në 1 vit përpara hulumtimeve të tyre të fertilitetit) të marrëdhënieve të rregullta seksuale të pambrojtura.

1.8 Inseminimi intrauterin

1.8.1 Inseminimi intrauterin

Konsideroni inseminimin intrauterin të pastimuluar si një opion trajtimi në grupet e mëposhtme si një alternativë ndaj marrëdhënieve seksuale vaginale:

1.8.1.1.1 personat që nuk janë në gjendje ose do ta kishin shumë të vështirë të kryenin marrëdhënie vaginale për shkak të një paaftësie fizike të diagnostikuar klinikisht ose problemit psikoseksual, të cilët përdorin spermën e partnerit ose dhuruesit.

1.8.1.1.2 personat në kondita që kërkojnë konsideratë specifike në lidhje me metodat e ngjizjes (për shembull, pas larjes së spermës ku burri është HIV pozitiv)

1.8.1.2 Për personat (çiftin) në rekomandimin 1.9.1.1 që nuk kanë konceptuar pas 6 cikle të inseminimit me donatorë ose partnerë, pavarësisht dëshmime të ovulacionit normal, kalueshmërisë së tubave dhe analizës së spermës, udhezohen në procedurë tjera të FAM.

1.8.1.3 Për njerëzit me infertilitet të pashpjegueshëm, endometrioze të moderuar ose infertilitet të moderuar të faktorit mashkullor, të cilët kryejnë marrëdhënie të rregullta seksuale të pambrojtura:

1.8.1.3.1 mos ofroni në mënyrë rutinore inseminim intrauterin, qoftë me ose pa stimulim ovarial (rrethanat e jashtëzakonshme përfshijnë, për shembull, kur njerëzit kanë kundërshtime sociale, kulturore ose fetare ndaj FAM)

1.8.1.3.2 këshilloni ata që të përpiqen për të provuar shtatzanine për një periudhë kohore prej 2 vitesh (kjo mund të përfshijë deri në 1 vit përpara hulumtimeve të tyre të fertilitetit) përpara se FAM të merret parasysht.

1.9 Parashikimi i suksesit të FAM

1.9.1 Mosha e femres

- 1.9.1.1** Informoni gratë se mundësia e një lindjeje të suksesshme të foshnjes së gjallë pas trajtimit me FAM bie me rritjen e moshës së femrës .

1.9.2 Numri i cikleve të mëparshme të trajtimit

- 1.9.2.1** Informoni njerëzit se mundësia e përgjithshme për një lindje të gjallë pas trajtimit me FAM bie ndërsa numri i cikleve të pasuksesshme rritet.

1.9.3 Historia e mëparshme e shtatzënisë

- 1.9.3.1** Çiftet duhet të informohen se trajtimi me FAM është më efektiv tek gratë që kanë qenë më parë shtatzëna dhe/ose kanë pasur një lindje me femije të gjallë.

1.9.4 Indeksi i masës trupore (BMI)

- 1.9.4.1** Gratë duhet të informohen se BMI-ja e femrës do të ishte ideale në vlerat prej 19 deri në 30 përpara se të fillojë me metoda të riprodhimit të asistuar dhe se një vlerë e BMI të femrës jashtë këtij diapazoni ka të ngjarë të zvogëlojë suksesin e procedurave të riprodhimit të asistuar.

1.9.5 Faktorët e stilit të jetesës

- 1.9.5.1** Çiftet duhet të informohen se konsumimi i më shumë se 1 njësi alkooli në ditë redukton efektivitetin e procedurave të riprodhimit të asistuar, përfshirë FAM.
- 1.9.5.2** Çiftet duhet të informohen se pirja e duhanit nga nëna dhe nga babai mund të ndikojë negativisht në shkallën e suksesit të procedurave të riprodhimit të asistuar, duke përfshirë trajtimin me FAM.
- 1.9.5.3** Çiftet duhet të informohen se konsumimi i kafeinës nga nëna ka

efekte negative në shkallën e suksesit të procedurave të riprodhimit të asistuar, duke përfshirë trajtimin me FAM.

1.10 Kriteret e aksesit për FAM

1.10.1 Kriteret për referim për FAM

1.10.1.1 Informoni çiftet që normalisht një cikël i plotë i trajtimit i FAM-it me ose pa injeksion intracitoplazmatik të spermës (ICSI), duhet të përfshijë 1 episod të stimulimit ovarial dhe transferimin e çdo embrioni(ve) të freskët dhe të ngrirë që rezulton.

1.10.1.2 Grave deri në moshën 42 vjeçe që nuk kanë mbetur shtatzënë pas 2 vitesh marrëdhënie të rregullta të pambrojtura ose 6 cikle të inseminimit artificial , ofroni 3 cikle të plota të IVF kur:

Ata nuk kanë pasur kurrë më parë trajtim me FAM

Nuk ka dëshmi të rezervës së ulët të vezoreve .

Ka pasur një diskutim për implikimet shtese të FAM-it dhe shtatzënie në këtë moshë.

Aty ku hetimet tregojnë se nuk ka asnjë shans (gjase) për shtatzëni me menaxhimin e pritur dhe ku FAM është i vetmi trajtim efektiv, referojeni gruan direkt tek një ekip specialist për trajtimin me FAM.

